



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.363/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Poterqoi – Kryetar, znj. Nita Bejta – Referuese, z. Agon Ramadani - Anëtar, znj. Vjosa Gradinaj – Mexhuani – Anëtare, znj. Kimete Gashi – Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “TSR SHPK”.-Prishtinë, kundër vendimit të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal - LOT - 4”, me nr. të prok: 616-22-2845-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë, më datën: 03.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal - LOT - 4”, me nr. të prok: 616-22-2845-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë,

II. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

IV. LEJOHET, kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës nga operatori ekonomik ankues: “TSR SHPK”.-Prishtinë, i .

V .Obligohet operatori ekonomik ankues: “TSR SHPK”.-Prishtinë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “TSR SHPK”.-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.08.2022 me nr. 363/22, kundër njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal - LOT - 4”, me nr. të prok: 616-22-2845-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 57, 59, 69, si dhe nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 29.08.2022, ka autorizuar dy(2) ekspert shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.09.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sgarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - “Komuna Prishtine”, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore sipas deklaratës ne ankese kane te bëjnë kundër propozimit për dhënie te kontratës ne lotin 4 te këtij aktivitetit te prokurimit.

Parashtruesi i ankesës përmes kërkesës për ri shqyrtim te datës 09.08.2022, kërkon ri vlerësim te lotit 4, megjithatë AK – Komuna Prishtine përmes vendimit te te njëjtës date refuzon kërkesën si te pa bazuar me arsyetimin kryesore se OE ankues i është dhënë kontrata ne lot 2 dhe nuk mund te jete pale me interes për lotin 4 , pasi qe ne piken 2.5 te Dosjes se tenderit (FDT) numri i pjesëve qe mund te shpërblehet një OE është 1.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113): *Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër ri vlerësimit te ofertave përkatësisht kundër rekomandimit për dhënie te kontratës ne Lot 4.*

Ne Interpretim te pretendimeve ankimore sqarojmë se AK – Komuna Prishtine ne platformën e-prokurimit lidhur me këtë aktivitet te prokurimit i ka aplikuar gjithsej 4 lote, tek rubrika “përshkrimi i çmimeve”, ka ngarkuar gjithsej 4 paramasa – përshkrim te çmimeve ku te gjitha rezultojnë te jene për lotin 1.

Sipas njoftimit – vendimit te AK-se te datës 08.07.2022, OE tani i rekomanduar ne lot 4 “Lindi Markings shpk & Beni Com shpk, është eliminuar me arsyetimin se “Mostra e sinjalizimit vertikal është kërkuar te jete DG kurse OE e ka dorëzuar EGP”, rrjedhimisht AK, kishte propozuar anulimin e lotit 4 ne mungese te ofertave te përgjegjshme.

Me datën 13.07.2022 OE “Lindi Markings shpk & Beni Com” shpk, paraqesin kërkesë për ri shqyrtim, ne lot 4, ndërsa AK – Komuna Prishtine përmes vendimit te datës 14.07.2022, aprovon kërkesën dhe lenden e kthen ne rivlerësim.

Përderisa me datën 04.08.2022 AK, përmes letrës standarde ne Lot 4, te njëjtin OE shpërblen me kontrate me çmim te poentuar ne vlere prej 139.00 €.

Sipas pretendimit ankimore te parashtruesit te ankesës sqarojmë se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ne lot 4 pas ri vlerësimit te ofertave ka ofertuar ne paramas te lotit 1, përderisa është rekomanduar për dhënie ne lot 4.

Po ti referohemi shkresave te lendes ofertës se OE “Lindi Maklings shpk & Beni Com, rezulton qe i njëjti sipas krijimit te grupit – konsorciumit si dhe Formularit për dorëzim te tenderit ka ofertuar ne lotin 4. Përderisa ka ofertuar me oferte financiare te lotit 1 .

Se bashku me raport si prove bashkangjitur gjeni kopjen e vendimit te AK-se te datës 29.03.2022.

Përgjigje për pretendimin ankimor 2

Duke u bazuar në ofertën e dorëzuar nga OE fitues për LOT 4, pra ofertë e cila nuk korrespondon me kërkesat tenderuese, atëherë del që nga aspekti teknik me pajisjet e ofertuara nuk mund të kryhen punët e parapara për LOT 4. Pra teknikisht është e pamundur që të kryhen punët e kërkuara me punët të cilat mund të i kryejnë pajisjet apo elementet teknike .

Po e cekim elementin në pozicionin e parë tek AK e cila kërkon pajisje : Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e shtegut për biçikleta me ngjyrë të kuqe te trafiku, Materiali baze masa plastice dedikuar vetem per shtigje te ciklisteve, me dy apo tre komponente. Karakteristikat teknike jane: Densiteti min. 1.8 - 2 kg/l, Temperatura procesuese min. +5 C, temperatura e asfaltit +5 C -- +45 C, Trashesia minimale 1 - 1.5 mm, Consumi min. 2 kg/m2. Perzierja 100:1, Perla vezulluese: Indeksi I reflektivitetit: Class A sipas EN 1423, Pesha specifike 1.6 – 1.8 g/cm3, Perberja e materialeve te rrezikshme: < 200 ppm, te As,Pb,Sb – Class 1, Ngjyra duhet te kete certifikaten e qendrushmerise sipas standardit: UNE – EN 1436 – te dorezohet me ofertë. Materiali duhet te kete veti kunder rreshqitjes qe ti mundesoje ciklistave ngasje te sigurte.

Ndërsa pajisjet të cilat i ka ofertuar OE për këtë pjesë janë :

1. SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL PJESA URBANE DHE RURALE-LLOTO					
KONTRATË KORNIZË					
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Shuma me TVSH
A. Totali (100% e përzierjes për vlerësim)					
A.	Masa Plastik, duhet të jetë e ngurt. Trashesia e vendosjes duhet të jetë nga 0.3-0.5 mm me grunça të helqit dhe rërës (Furnizimi, transporti dhe sinjalizimi me vijë Figura.1				
1	Vërejtje:Vija duhet të jetë e ndërprerë, e pandërprerë, shigjetë orientuese njëshe, dyshe, të kombinuar, vendkalimet e	m ²	1	35	35.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelave trekëndëshe, rrethore dhe katrore Baza 900 mm, Ø600 dhe 600x600[mm] me kualitet të filmit "Diamond Grade" figura 10, – çmimi përfshinë: Furnizimin e tabelës, shtyllës, montimi i tabelës dhe shtyllës në lartësi minimale nga	copë	1	35	35.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelave gjashte këndesh (Stop) Baza 600 mm, Ø600 dhe 600x600[mm] me kualitet të filmit "Diamond Grade" – çmimi përfshinë: Furnizimin e tabelës, shtyllës, montimi i tabelës dhe shtyllës në lartësi minimale nga	copë	1	18	18.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelës anësore në vendet ku kemi ngushtim të rrugës dhe ndarje fizike të shiritave rrugor, Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelës kryqit të andreut, punohet sipas skicës të paraqitur me kualitet të filmit "Diamond Grade" – çmimi përfshinë:	copë	1	6	6.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelës kryqit të andreut, punohet sipas skicës të paraqitur me kualitet të filmit "Diamond Grade" – çmimi përfshinë:	copë	1	4	4.00 €

Pretendimi i OE për shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik (saktësisht të nenit 6) qendron.

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

- Pra shfrytëzimi i burimeve publike nuk është e mundur të bëhet për qëllimit për të cilin ka aplikuar OE , respektivisht për LOT 4 (Me ofertë për LOT 1).

Nga ajo që kemi hulumtuar në lidhje me aspektin teknik, shohim se AK e ka shkelur Nenin 28 të LPP, përkatësisht pikën 9, e cila thotë : Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrën më të përshtatshme (siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimi nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me specifikimet e lartpërmendura gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale të autoritetit kontraktues.

Përgjigje për pretendimin ankimor 3

Tek pretendimi ankimor nr. 3 OE ankues pretendon që është shkelur neni 7 i LPP, për trajtim jo të barabartë dhe diskriminim. Këtu OE ankues pretendon që OE fitues nuk i plotëson kriteret nga aspekti i makinerive teknike si dhe projekteve të tjera të realizuara të ngjajshme.

Lidhur me këtë pretendim , vlerësojmë si më poshtë:

Koncerciumi (OE) fitues ka paraqitur projektet të cilat i ka realizuar, të cilat disa janë të ngjajshme me natyrën e tenderit (Disa tek kompania Lindi Markings), ndërsa tek OE tjetër Beni-com janë projekte kryesisht të ndertimit të rrugëve dhe objekteve në të cilat OE nuk ka kryer punë të sinjalizimit të cilat kerkohen për aktivitetin e prokurimit.

Për pjesën e makinerive, do të ndalemi tek pretendimi ankimor nr.5.

Përgjigje për pretendimin ankimor 4

OE ankues pretendon që AK e ka shkelur nenin 57 të LPP, pra atë të sigurimit të tenderit. Pra me pretekstin që OE fitues ka me kerkesë të LOT 1, ndërsa sigurimin e ka bërë për LOT 4 (Pra 4000 Euro, në vënd të 6000 Euro). Pretendimi nr. 4 qendron, pasi që OE ka bërë ofertim tjetër dhe sigurim tjetër nga ai që e ka kërkuar AK për LOT respektiv (4).

Pra OE fitues është dashur të ofertoj me paramasën e kërkuar për Lot 4 dhe të paraqesë sigurimin (4000 Euro), dhe jo të ofertoj me paramasë për Lot 1, dhe me sigurim për Lot 4 (4000 Euro).

Përgjigje për pretendimin ankimor 5

OE ankues pretendon se AK e ka shkelur nenin 59 të LPP, dhe kjo qendron. Pasi që Neni 59 i LPP, më saktësisht pika 4 potencon si më poshtë:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve

Baza teknike për këtë : Duke pasur parasysh që OE fitues nuk ka ofertuar me paramasë të kërkuar për Lot 4, atëhere kjo nënkupton që nuk kemi të bëjm me gabime apo devijime të vogla, mirëpo kemi të bëjm me karakteristika dhe paramasa krejtësisht të tjera nga ato të cilat kerkohen. Pasi që shtresa për shtegun e çiklistëve kërkon materialin me karakteristika të veçanta fizike dhe kimike me anë të të cilave shtresa bëhët më e sigurtë në aspektin e qarkullimit të çiklistëve në atë sipërfaqe.

Me tutje OE ankues pretendon që konserciumi nuk e plotëson kushtin e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit (kontrata të ngajshme). AK në dosjen e tenderit ka kërkuar si më poshtë:

Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Gjatë hulumtimit kemi parë që janë derguar listat me kontrata si me të dhënat e kërkuara. Mirëpo projektet e Beni-Com siç e kemi cekur edhe në përgjigjen për pretendimin 3, se nuk janë të ngjajshme me fushën e tenderimit. Po ashtu OE fitues nuk ka sjellur referenca apo certifikata të kryerjes së punëve të cilat i ka kërkuar AK në dosjen e tenderit. AK ka kërkuar që OE të paraqesë dëshmi të kryerjes së punëve të sinjalizimit, apo që nderlidhen me sinjalizim (që ka sinjalizim në to), në menyrë që OE të jetë e përgatitur në këtë fushë dhe të kryej punët në menyrën sa më të mirë të mundshme. Pra që të jetë e përgatitur dhe profesionale në këtë fushë, nga aspekti i i pajisjve teknike e po ashtu edhe nga stafi i kualifikuar.

Në këtë pikë, OE ankues pretendon se OE fitues nuk i plotëson as kriterin sa i përket stafit të kualifikuar dhe punëtorëve të kërkuar nga AK.

AK në dosjen e tenderit ka parashtruar kerkesën sa i përket stafit të punëtorëve si më poshtë:

Ekipa për punimet në sinjalizimin Horizontal dhe vertikal 1- Menaxher i projektit inxhinier të komunikacionit apo bachelor rrugor, 1 teknikë të komunikacionit rrugor, 6 punëtorë. Për inxhinieret CV-a, Kopja e Diplomës, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Për punëtorët tjerë lista e stafit me CV, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt

Ky pretendim i OE ankues nuk qendron, pasi që koncerciumi (OE fitues) ka paraqitur ekipën për punime në sinjalizim sipas kerkesës së AK në dosjen e tenderit. Pra janë ashtu siç kerkohet në dosjen e tenderit.

Po ashtu tek pretendimi nr.5, OE ankues pretendon se OE fitues nuk ka paraqitur një autorizim për produktet e sinjalizimit vertikal dhe horizontal siç kerkohet nga AK në dosjen e tenderit.

AK në dosjen e tenderit ka kërkuar si më poshtë:

Autorizimin origjinal të prodhuesit (apo distributorit të autorizuar) për produktet e sinjalizimit horizontal dhe vertikal. Kopja e Autorizimit të prodhuesit (apo distributorit të autorizuar)

OE fitues ka paraqitur 2 autorizime, nga 2 përfaqësues të ndryshëm për materiale apo pajisje të ndryshme. Tek njëri autorizim , autorizimi vlerësohet se është në rregull. Ndërsa tek autorizimi për llamarinë dhe gypa të zinkuar nga Sunguri, si distributor i autorizuar nga kompania Liberty AD nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi e cila e vërteton këtë .

Tjetër pretendim në kuadër të pikës 5 nga OE ankues është edhe tek pajisja speciale, të cilën AK e ka kërkuar që të jetë me program kompjuterik . AK ka paraqitur kërkesën si më poshtë për makinën speciale:

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor- Llot-I, II, III, IV		Sasia e kërkuar (cope)
1.	<p>Makina special mas plastike ≥ 3 mm</p> <p>I. Makine duhet te kete kompjuterin me mundesi të programimit e po ashtu te kete mundesin e gjysemautomatike dhe manual;</p> <p>II. Makina duhet të kete papucet per mase plastike ≥15cm, deri 20cm;</p> <p>III. Te kete te integruar edhe shperndarjen e fosforit dnuh (perloritautomatik);</p> <p>IV. Te ketë timon dhe ulese ;</p> <p>V. kapaciteti ≥ 500 m/h;</p> <p>VI. Makina duhet të ketë kompjuterin për punimin e vijës sipas kërkesës p.sh.: 3-3 3-1, 1-1 , me minimum 3 programe me mundësi te zgjedhjes sipas nevojës;</p>	pronësi apo me marrëveshje	1

OE ankues po ashtu pretendon që OE fitues nuk e ka plotësuar kushtin edhe sa i përket kësaj kërkesë të AK: Makinë special për fshirjen dhe rrafshimit e rrugëve para vendosjes së sinjalizimit horizontal, fuçia e motorit ≥30 kw.

OE ankues pretendon se makina speciale e ofruar nga OE fitues ka fuqi të motorit vetëm 2KW. (Duhet të shikohet në karakteristika të pajisjes se sa e ka fuqinë e motorit makina e ofruar nga OE fitues, pasi qe sipas DUD-it doganor te te njëjtës pajisje nuk ka te dhëna lidhur me fuqinë motorike (KW)

OE ankues pretendon që OE fitues nuk ka dërguar dëshmi që posedon Rimorkio me elemente sinjalizimi (për paralajmërim për punime në rrugë). Pra se OE fitues ka prezantuar vetëm një rimorkio të thjeshtë pa këto elemente shtesë. Ky pretendim qëndron, pasi që OE fitues nuk ka paraqitur dëshmi të cilat e plotësojnë kërkesën e AK.

AK po ashtu ka kërkuar edhe rimorkio speciale si më poshtë :

IV. Rimorkio me elemnete sinjalizimit (për paralajmrim per punime në rrugë)

OE fitues ka prezantuar që ka në pronësi një rimorkio të tipit Hendrick Kleve, e cila nuk deshmon që ka pajisjet apo elementet e kërkuara nga AK në tender.

Po ashtu OE ankues pretendon se OE fitues nuk posedon (Makineri printimi adeziv (folie reflektuese) i certifikuar për sinjalistike rrugore).

OE fitues ka paraqitur makinën : PLOTER Mimaki 250 (Duhet të shikohen karakteristikat e saj shikohet se a është ofruar një dëshmi që është e certifikuar për sinjalistikë rrugore, rrjedhimisht nuk janë prezantuar dëshmi lidhur me certifikimin e pajisjes.

Përgjigje për pretendimin ankimor 6

Në këtë pretendim, OE ankues pretendon që AK ka shkelur nenin 69 të LPP, pra duke u bazuar në dëshmitë të cilat i ka paraqitur në pretendimet e më hershme. Neni 69 i LPP thotë :

Neni 69 : Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen.

Duke u bazuar në atë , se AK i ka dhënë kontrate një OE i cili ka ofruar tjetër paramasa me atë të cilat kërkohen për LOT respekti, mund të themi se pretendimi i OE ankues për këtë pikë qëndron.

Përgjigje për pretendimin ankimor 7

Tek pretendimi ankimor nr.7, OE ankues pretendon se ju ka bërë e padrejtë pasi që AK e ka shpallur si palë pa interes (OE ankues) për LOT 4 (Me arsyetimin se ajo e ka fituar LOT 2).

Duke u bazuar në dosjen e tenderit, dhe specifikat dhe elementet të cilat AK i ka cekur në tender atëhere vlerësojmë se AK e ka cekur mjaftë mirë në tender si më poshtë (Pika 2.5 Ndarja në LOTE) :

Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 1

Pra AK e ka cekur mjaftë mirë se numri maksimal i pjesëve (loteve) që mund të fitoj një tenderues është 1. Prandaj AK me të drejtë e ka shpallur OE ankues si palë pa interes për LOT 4.

AK ka të drejtë që të bëjë shpërndarjen e Loteve (pjesëve) në tenderues të ndryshëm, pasi që një gjë e tillë nuk i kufizohet nga LPP. OE ankues do të kishte të drejtë nëse AK nuk do të e përcaktonte në tender një gjë të tillë, mirëpo pasi që AK e ka cekur një gjë të tillë atëhere pretendimi i OE ankues që i është bërë e padrejtë nuk qëndron.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertët propozojnë për panelin shqyrtues që ankesa e OE ankues, “TSR SHPK”, për shpallje fitues të OE Lindi Markings Shpk dhe Beni-Com aprovohet si e bazuar (duke u bazuar në shpjegimet që janë dhënë në secilin pretendim). Respektivisht, që AK e ka shpallur fitues OE e cekur me lartë, edhe pse ai ka ofruar paramasa të tjera nga ato që kërkohen në tender (e po ashtu edhe specifika të tjera të cilat janë përmendur në këtë raport ekspertize). Ekspertët propozojnë për panelin shqyrtues që të refuzohet kërkesa e OE (TSR Shpk) që loti 4, të kthehet në rivlerësim . Dhe kështu ky lot (4) i këtij aktiviteti të prokurimit të anulohet.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 06.09.2022, me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës, me datë: 06.09.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, pajtohet me mendimin e ekspertit.

Operatori Ekonomik: “TSR SHPK”– Prishtinë, me datë: 08.09.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 30.09.2022, me praninë e palëve në procedurë ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverballi mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Paneli Shqyrtues e mbështetet raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues i prokurimit dhe eksperti teknik, të cilët janë caktuar nga OSHP, detyrë e të cilëve ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe propozimi i tyre për panelin shqyrtues është që të refuzohet kërkesa e OE (TSR Shpk) që loti 4, të kthehet në rivlerësim. Dhe kështu ky lot (4) i këtij aktiviteti të prokurimit të anulohet. Andaj, edhe PSH konstaton se LOT 4 duhet të anulohet. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga ekspertët shqyrtues llogariten si arsye të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendim.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale -Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK - Prishtinë”,
- 1x1 OE - “TSR SH.P.K.”– Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

